



REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 724/3 Prot.

Patos, më 17/04 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 16 PRILL 2024

Vendi: "Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak"

Ora e fillimit : 14 :00

Ora e mbarimit : 15: 30

Tema e Konsultimit: "Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit me nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB-së nr. 80 datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

Pjesëmarrës: Zv. Kryetare e Bashkisë znj. Ina Sauli, Sekretare e Këshillit znj. Refacla Xeba, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, Mesues, Përfaqësues të KVR-së Patos Përfaqësues të DRAP Fier, dhe rreth 24 të nxënës të shkollave të mesme, të ndodhura në territorin e bashkisë Patos.

Takimin hapet nga Anëtari i Këshillit të Bashkisë Patos z. Erald Çepele:

Anëtari i Këshillit të Bashkisë Patos z. Erald Çepele – të nderuar pjesëmarrës më lejoni së pari t'ju falenderoj në emër të Këshillit të Bashkisë për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ me teme: "Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" i cili realizohet në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit me nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin

publik” ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB-së nr. 80 datë 18.12.2023 për kalendarin e përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025” dhe konsiston në marrjen e kërkesave prioritare, të cilat ju mendoni se keni nevojë dhe padiskutim që cdo kërkesë e juaja do të regjistrohet nga ana jonë dhe tani fjala është për ju.



**Anëtari i Këshillit të Bashkisë Patos
z. Erald Çepele**

Dëgjesë Publike me temë :

***“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm
2025-2027”.***

Prill 2024

Nxënës i shkollës “Zhani Ciko” Sokol Baxhia : - kërkoj që një pjesë e buxhetit të të rinjve kalojë për logjistikën e qendrës rinore.



**Nxënës i shkollës “Zhani Ciko”
Sokol Baxhia**

Dëgjesë Publike me temë :

***“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin
e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-
2027”.***

Prill 2024

Nxënës i shkollës “Sotir Çapo” Gerald Avdullau:- lidhur me shkollën “Sotir Çapo” kërkoj rikonstruksionin total gjithashtu kërkoj të ndërhyet për fushën e sportit të fshatit Verbas.




**Nxënës i shkollës “Sotir Çapo”
Gerald Avdullau**

Dëgjesë Publike me temë :

***“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor
Afatmesëm 2025-2027”.***

Prill 2024

Nxënëse e shkollës “Mustafa Matohiti” Xhoela Murataj : - kërkoj që në shkollën tonë të blihen kompjutera gjithashtu të bëhet infrastruktura rrugore në lagjen tonë dhe mbi të dhitha ne nuk marrim pagesë për transportin sic marrin mësuesit.



**Nxënëse e shkollës “Mustafa Matohiti”
Xhoela Murataj**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm
2025-2027”.*

Prill 2024

Nxënësi i shkollës “Sotir Çapo” Reivi Mamo : - në shkollën tonë në fshatin Zharrëz në vendin ku qëndron polici i cili ndihmon nxënësit për kalimin e rrugës kërkojë të vendoset semafor pasi është burim aksidenti. Gjithashtu rruga për në fshatin Verbas dhe deri te kthesa e kryqit nuk ka trotuar dhe për të shkuar në shkollë do të na duhet që të kalojmë në rrugën e makinave dhe kjo na bën të jemi të pasigurt gjatë rrugës dhe kjo rrugë nuk përshkohet vetëm nga ne por nga të gjithë banorët e zonës.



**Drejtore e Financës
znj. Mimoza Shtëmbari**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor
Afatmesëm 2025-2027”.*

Prill 2024

Drejtore e Financës znj. Mimoza Shtëmbari – padiskutim që serioziteti i kërkesave tuaja na vendos ne si admimistratë në prozitet pune. Lidhur mbi kërkesën për infrastrukturën rrugore, duke përfshirë sinjalistikën horizontale dhe vertikale por edhe për vendosjen e semaforëve e kemi të pamundur për momentin pasi jemi në fazat e ndëryrjeve të rrugëve parësore ndërsa projekti për shkollën “Sotir Capo” është gati dhe jemi në fazën e aplikimit të projektit për rikonstruksionin e shkollës .

Nxënësë i shkollës “Meleq Gostinishti” Xhoeljo Mukaj : - në shkollën Meleq Gostinishti kemi mungesën e kabinetit të komisë, informatikës dhe fizikës dhe këto janë kabinete të cilat ndikojnë shumë në zhvillimin tonë si nxënës.



**Nxënësë i shkollës “Meleq Gostinishti”
Xhoeljo Mukaj**

Dëgjesë Publike me temë :

“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Prill 2024

Drejtores e Financës znj. Mimoza Shtëmbari:– kjo është detyrë e Drejtorisë Arsimore vendore e cila duhet të pajisë shkollat me kabinete pasi bashkia si institucion ka për detyrë



**Drejtores e Financës
znj. Mimoza Shtëmbari**

Dëgjesë Publike me temë :

“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Prill 2024

mirëmbajtjen infrastrukturore të godinave por të ndodhur përpara këtij fakti dhe në këto kushte ne mund t’ju ndihmojmë në mënyrën se si mund të bëni një kërkesë për t’ia drejtuar Drejtorisë së Arsimit për paisjen e shkollave me kabinete.

Nxënës i shkollës “Meleq Gostinishti” Xhoeljo Mukaj: - në shkollën tonë nuk është bërë asnjë orë informatikë dhe ne kërkojmë kabinete mësimore për zhvillimin arsimor.



**Nxënës i shkollës “Meleq Gostinishti”
Xhoeljo Mukaj**

Dëgjesë Publike me temë :

“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Prill 2024

Anëtare e këshillit të bashkisë znj. Vjollca Kasaj - keni më afër shkollën Muhamet Shehu dhe ju keni detyrimin të shkoni kjo shkollë dhe si brez i ri që jeni ju duhet të fokusoheni në kërkesat të cilat do të ndikojnë në zhvillimin tuaj kulturor pasi shtrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve është detyrimi i bashkisë



**Anëtari i Këshillit të Bashkisë Patos
znj. Vjollca Kasaj**

Dëgjesë Publike me temë :

***“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin
e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-
2027”.***

Prill 2024

Anëtari i Këshillit të Bashkisë Patos z. Erald Çepele – në qytetin e patosit tre shkolla janë bërë model dhe shpresojmë që me këtë buxhet edhe shkolla juaj të ketë rikonstruksion. Lidhur mbi problemin e trotuarit ajo është rrugë nacionale dhe nuk është në inventarin e bashkisë por nëse nuk gaboje është në drejtorinë e përgjithshme të rrugëve dhe mbi të gjitha është jashtë vijës së verdhë të qytetit pavarësisht dëshirës që mund të kemi ne për të bërë trotuar.

Nxënësi i shkollës “Meleq Gostinishti” Xhoeljo Muka: - kërkoj që përbri stadiumit të bëhet një kënd sportiv



**Nxënësi i shkollës “Meleq Gostinishti”
Xhoeljo Muka**

Dëgjesë Publike me temë :

***“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor
Afatmesëm 2025-2027”.***

Prill 2024

Nxënëse e shkollës “Mustafa Matohiti” Fjoralba Elezaj – laboratori i informatikës mungon dhe ajo që është më e rëndësishme është fakti që nxënësit nga Ruzhdija nuk kanë



**Nxënëse i shkollës “Mustafa Matohiti”
Fjoralba Elezaj**

Dëgjesë Publike me temë :

***“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm
2025-2027”.***

Prill 2024

transport publik për të ardhur në shkollën Muhamet Shehu dhe është e drejtë ajo që tha vajza pak më parë përse për mësuesit ofrohet pagesa për transportin ndërsa për nxënësit jo

Anëtari i Këshillit të Bashkisë Patos z. Erald Çepele: – sot ne sa kemi përfunduar mbledhjen e këshillit ku kemi marrë vendim për vendosjen e linjës së transportit publik ndërsa lidhur mbi kompesimin e transportit për nxënësit nuk e kam si informacion dhe në cilësinë e anëtarit të këshillit do ti kërkoj ekzekutivit informacion lidhur mbi shqetësimin tuaj.

Nxënëse i shkollës “Meleq Gostinishti” Ermonela Muskaj: - salla e kinemasë kërkon rikonstruksion pasi stolat janë të dëmtuar



**Nxënës i shkollës “Meleq Gostinishti”
Ermonela Muskaj**

Dëgjesë Publike me temë :

***“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor
Afatmesëm 2025-2027”.***

Prill 2024

Anëtari i Këshillit të Bashkisë Patos z. Erald Çepele: – Ju falenderoj për shqetësimin edhe kjo është diskutuar në takimet e mëparshme dhe në dijeninë time është duke u bërë projekti nga ana e zyrës së projekteve në bashki dhe financimi i saj do të kërkohet që të bëhet me

financim nga qeveria pasi aty nuk kërkohet vetëm stola, por si godinë kërkon rikonstrukcion total të saj.

Nxënës i shkollës “Sotir Çapo” Haxhi Fetahu : - Kërkojmë rethimin e kalçetos së fushës në fshatin zharrzës.



**Nxënës i shkollës “Sotir Çapo”
Haxhi Fetahu :**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor
Afatmesëm 2025-2027”.*

Prill 2024

Anëtar i këshillit të bashkisë z. Erald Cepele: – unë ju falenderoj lidhur mbi cdo kërkesë apo koment tuajin mbi kërkesat prioritare për hartimin e buxhetit afatmesëm 2026-2027, nëse nuk keni gjë tjetër për të shtuar e deklaroj këtë takim konsultativ të mbyllur duke ju falenderuar për pjesëmarrjen tuaj dhe padiskutim për cdo sygjërim të dhënë.

Konceptoi:

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj

A blue ink signature of Suzana Hysenaj, written over the text of her name.

Pranoi:

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba

A blue ink signature of Refaela Xeba, written below her name.

Foto të dëgjesës publike me temë: “Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

